

FOTO ALBUM

— 2020 —

PHOTO ALBUM

Përgatitën për botim: Dr. Ornela Arapi
Dr. Brunilda Çërraga

Redaktor: Inpress sh.p.k.

Dizajn: Inpress sh.p.k.

Copyright: Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit

Shtypshkronja “**Inpress sh.p.k.**”

Prepared for publication: Dr. Ornela Arapi
Dr. Brunilda Çërraga

Editor: Inpress sh.p.k.

Design: Inpress sh.p.k.

Copyright: Authority for Information on the Former State Security Documents

Printing House “**Inpress sh.p.k.**”

VIZITË E AMBASADORIT TË IZRAELIT NË SHQIPËRI, Z. NOAH GAL GENDLER, NË AUTORITET

VISIT OF THE AMBASSADOR OF ISRAEL IN ALBANIA, MR. NOAH GAL GENDLER, AT THE AUTHORITY OFFICES

13 Janar 2020 / 13 January 2020

Ambasadori Izraelit në Shqipëri, z. Noah Gal Gendler, zhvilloi një vizitë në mjediset e Autoritetit, ku u njoh me punën dhe projektet e institucionit dhe rolin e AIDSSH-së, për drejtësinë tranzicionale në vend.

The Ambassador of Israel in Albania, Mr. Noah Gal Gendler had a visit at the Authority Office. During his visit he was informed on the work and the projects of the institution and the role of AIDSSH for transitional justice in the country.



Në foto: z. Noah Gal Gendler, Ambasador i Izraelit në Shqipëri dhe Znj. Gentiana Sula, Kryetare e AIDSSH-së

In this photo: Mr. Noah Gal Gendler Ambassador of Israel in Albania and Ms. Gentiana Sula, Chairwoman of the Authority

PËRVOJA POLAKE NË ZBARDHJEN E SË SHKUARËS DHE RIKTHIMIN E DINJITETIT VIKTIMAVE TË TOTALITARIZMIT

POLISH EXPERIENCE RELATED TO DISCOVERY THE PAST AND RESTORING THE IDENTITY TO THE VICTIMS OF TOTALITARIANISM

3-6 Shkurt 2020 / 3-6 February 2020

Vizitë e Autoritetit në Institutin Polak Kombëtar të Kujtesës, Varshavë, Poloni.

Delegacioni shqiptar përfaqësohej nga kryetarja, znj. Gentiana Sula, anëtarët, z. Simon Mirakaj, z. Marenglen Kasmi dhe z. Altin Hoxha, deputetët e Komisionit të Ligjeve, znj. Artemis Dralo dhe z. Edmond Leka dhe Ministrja e Kulturës e Shqipërisë, znj. Elva Margariti.

Visit of the Authority at the National Polish Institute of Remembrance (Institute Pamięci Narodowej), Warsaw, Poland.

Albanian Delegation was represented by the chairwoman, Ms. Gentiana Sula, and the Members of the Authority, Mr. Simon Mirakaj, Mr. Marenglen Kasmi and Mr. Altin Hoxha, Deputies of the Law Commission, Ms. Artemis Dralo and Mr. Edmond Leka and the Minister of Culture of Albania, Ms. Elva Margariti.



KONFERENCA NDËRKOMBËTARE SHKENCORE “EMIGRACIONI POLITIK SHQIPTAR NË VITET 1944-1990”

INTERNATIONAL SCIENCE CONFERENCE “ALBANIAN POLITICAL IMMIGRATION IN THE YEARS 1944-1990”

19 Shkurt 2020 / 19 February 2020



Të pranishëm në Konferencë ishin Kryetarja e Autoritetit znj. Gentiana Sula, z. Bernd Borchardt, Ambasador i Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, Koordinator i Përhershëm i OKB-së në Shqipëri, z. Brian Williams dhe Ministri i Diasporës, z. Pandeli Majko, z. Ermal Frashëri, anëtar i Komitetit të Punëtorëve Migratorë në OKB, z. Gjon Radovani, arkitekt, i larguar me ambasadat në 1990-ën, si dhe z. Dritan Sejko, kryetar i shoqatës “Çamëria”, Prof. Asoc. Dr. Pranvera Dibra, me studiuesit: Beqir Meta, Dorian Koçi, Hamit Kaba, Enriketa Pandeimoni, Romeo Gurakuqi dhe Leonora Laçi, Gjon Boriçi, Kristale Ivezajt, Elma Ndrecës, Enis Sulstarovës, Lekë Tasit, Andrea Llukanit, të cilët u ndanë në 4 panele sipas tematikës.

Konferenca dhe ekspozita dokumentare mbi emigracionin, u prezantuan përgjatë datës 17 shkurt, në mjediset e Muzeut Historik Kombëtar, Tiranë. Për konferencën mbi emigracionin politik, Autoriteti dhe MEPJ ekspozuan dokumente të shumta arkivore, si pasqyra statistikore për të arratisurit, dosje drejtimi dhe kërkimi për të arratisur e të deklasuar, regjistra për personat në tentativë arratisjeje dhe albume fotografike të të arratisurve, që u përkasin qyteteve të ndryshme të vendit.





Present at the Conference were Chairwoman of the Authority, Ms. Gentiana Sula, Mr. Bernd Borchardt, Ambassador of the Presence of OSCE in Albania, Permanent Coordinator of the UN in Albania, Mr. Brian Williams and the Minister of Diaspora, Mr. Pandeli Majko, Mr. Ermal Frashëri, member of Committee of migrant workers in UN, Mr. Gjon Radovani, architect, immigrated in 1990, and Mr. Dritan Sejko, Chairman of Association “Çamëria”, Prof. Assoc Dr. Pranvera Dibra, Researchers Beqir Meta, Dorian Koçi, Hamit Kaba, Enriketa Pandeimoni, Romeo Gurakuqi and Leonora Laçi, Gjon Boriçi, Kristale Ivezajt, Elma Ndrecës, Enis Sulstarovës, Lekë Tasit, Andrea Llukanit, who were divided into four panels according to the topic.

The Conference and the documentary exhibition on the immigration was introduced during the day -17 February at the Historical National Museum, Tirana. For the Conference on political immigration, the Authority and MoFA exposed several archival documents, as statistical overview for the fugitives, their direction and search files, registers for persons attempting to escape and photo albums of escaped persons from different cities in the country.





KONFERENCË NDERKOMBËTARE SHKENCORE

EMIGRACIONI POLITIK SHQIPTAR 1944-1990

19 SHKURT 2020
MUZEU HISTORIK KOMBËTAR

Temat kryesore:

1. Veçoritë e krijimit të emigracionit politik shqiptar gjatë viteve 1944-1990;
2. Shtrirja gjeografike e emigracionit politik shqiptar;
3. Profile të emigrantëve politikë dhe veprimtaria e tyre;
4. Shoqatat e krijuara nga emigracioni politik shqiptar dhe qasja e tyre kundrejt Shqipërisë komuniste;
5. Operacioni "Rollback" dhe përfshirja në të e emigracionit politik shqiptar;
6. Reagimi i shtetit komunist shqiptar ndaj emigracionit politik shqiptar;
7. Veprimtaria e emigracionit politik shqiptar për mbrojtjen e interesave kombëtare shqiptare;
8. Kampet e emigrantëve në Europë.
9. Lufta e Ftohtë, marrëdhëniet e shtetit shqiptar me jugosllavët, grekët dhe italianët.








HOMAZHE NË NDERIM TË TË EKZEKUTUARVE NË MASAKRËN E 26 SHKURTIT

HOMAGE IN HONOR OF THOSE EXECUTED IN THE MASSACRE OF 26 FEBRUARY

26 Shkurt 2020 / 26 February 2020



Znj. Gentiana Sula, Kryetare e Autoritetit dhe z. Simon Mirakaj, anëtar i Autoritetit, pjesëtarë të AIDSSH-së, në bashkëpunim me familjarë, grupe interesi dhe pushtetin lokal, do të vijojë punën për përkujtimin e tyre.

Ms. Gentiana Sula, Chairwoman of the Authority and Mr. Simon Mirakaj, Member of the Authority, in collaboration with family members, interest groups and local government will follow the work for their commemoration.



VIJON ON LINE PUNA E AIDSSH

AIDSSH WORK CONTINUES ONLINE

Mars 2020 / March 2020

Në kushtet e reja të detyruara, për shkak të masave të marra në vend, mbi parandalimin e përhapjes së virusit COVID-19, puna e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit vijoi me takime online.

AIDSSH folloed the work for the information on the documents of Former State Security, under the new conditions imposed due to the measures taken in the country to prevent the spread of COVID-19.



TAKIM NË KUADËR TË DIALOGUT LOKAL

MEETING IN THE FRAME OF THE DIALOGUE WITH LOCAL GOVERNMENT

9 Qershor 2020 / 9 June 2020

Ekipi i AIDSSH-së dhe kryetarja, biseduan me Kryetaren e Bashkisë Kurbin, znj. Majlinda Cara, për dialogun e ardhshëm lokal, në zonë.

AIDSSH team and its Chairwoman, during the meeting with the Mayor of Kurbin, Mrs. Majlinda Cara for the next local dialogue in the area.



TAKIM ME ISH – TË DËNUAR POLITIKË

MEETING WITH FORMER POLITICAL CONVICT

14 Korrik 2020 / 14 July 2020

Kryetarja e AIDSSH-së, znj. Gentiana Sula u takua me z. Ylber Merdani dhe znj. Shpresa Balolli Merdani, në kuadër të bashkëpunimeve të AIDSSH me komunitetet lokale, për zbardhjen e historive të Korçës, Maliqit e Voskopojës dhe nderimin e personaliteteve në emër të rezistencës e solidaritetit njerëzor në diktaturë.

The Chairwoman of AIDSSH, Ms. Gentiana Sula met Mr. Ylber Merdani and Ms. Shpresa Balolli Merdani, in the frame of collaboration of AIDSSH with the local communities for discovering the history of Korça, Maliqi, Voskopoja and honouring personalities in the name of resistance and human solidarity in the dictatorship.



AMBASADORJA E SHBA-VE, ZNJ. YURI KIM, NË AIDSSH

THE US AMBASSADOR, MS. YURI KIM, AT AIDSSH

26 Qershor 2020 / 26 June 2020

Gjatë kësaj vizite, Ambasadorja e SHBA-së në Shqipëri, znj. Yuri Kim, u njoh me punën dhe sfidat e Autoritetit.

During this visit The US Ambassador in Albania, Ms. Yuri Kim was known with the work and challenges of the Authority.





TAKIM ME PËRFAQËSUES TË AMBASADËS SUEDEZE DHE TË AGJENCISË SUEDEZE PËR ZHVILLIM NDËRKOMBËTAR NË TIRANË

FIRST MEETING, WITH THE REPRESENTATIVES OF SWEDISH EMBASSY AND SIDA IN TIRANA

20 Qershor 2020 / 20 June 2020

Stafi i AIDSSH-së, në lidhje online me mbledhjen e projektit suedez.

AIDSSH's team in the on line meeting with the Swedish project.



Në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit midis Qeverisë Suedeze dhe AIDSSH, mbi financimin e projektit për rikonstruksionin e ndërtesës së aidssh-së dhe shërbimeve TIK për krijimin e një arkive moderne, u organizua takimi i parë i komitetit drejtues të projektit, me përfaqësues të ambasadës suedeze dhe të Agjencisë Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar në Tiranë, znj. Petra Burcher dhe znj. Linda Gjermani dhe AIDSSH, e përfaqësuar nga kryetarja, znj. Gentiana Sula dhe Sekretariati Teknik.

In the frame of the agreement of collaboration between Swedish Government and AIDSSH on the financing of the project for the reconstruction of the building of AIDSSH and TIK services for the creation of a modern archive, was organised first meeting of the directive committee of the project, with the representatives of Swedish Embassy and SIDA in Tirana, Ms. Petra Burcher and Ms. Linda Gjermani, and AIDSSH, represented by the Chairwoman Ms. Gentiana Sula and Technical Secretariat.

“DIALOGU LOKAL” TAKIME TË ZHVILLUARA NË SHKODËR

“LOCAL DIALOGUE” MEETINGS HELD IN SHKODER

Qershor 2020 / June 2020

Takim me Kryetaren e Bashkisë Shkodër, për dialogun lokal në Shkodër. Pjesëmarrës në takim, ishin: Kryetarja e Autoritetit znj. Gentiana Sula, z. Agron Hoxha – ish-i burgosur politik, z. Marçel Hila - koordinator i projektit për të zhdukurit me International Commission on Missing Persons (ICMP).

Meeting with the Mayor of Shkodër for the local dialogue Shkodër. Participant in the meeting, Chairwoman of the Authority Ms. Gentiana Sula, Mr. Agron Hoxha - former political prisoner, Mr. Marçel Hila - Coordinator of the project for missing persons with International Commission on Missing Persons (ICMP).



Vizitë në Muzeun e Kujtesës, Shkodër.

Visit in the Museum of Remembrance, Shkodër.

Dorëzimi i dosjes së përndjekjes nga ish-Sigurimi i Shtetit, Dom Gjergj Simonit.

Submission of the persecution file created by the Former Security State to Dom Gjergj Simoni.



TAKIM ME STUDIUES

MEETING WITH THE RESEARCHER

14 Korrik 2020 / 14 July 2020

Destan Dangëllia, në cilësinë e studiuesit, mori në dorë dosjen e martirit Sami Dangëllia, që mban rekordin tragjik të vuajtjes prej 43 vitesh, në burgje dhe internim.

Destan Dangëllia as a researcher read the martyr's file Sami Dangëllia, which holds the tragic record of persecution for 43 years in prisons and exile.



AKTIVITET NË FSHATIN GOSTIMË TË BASHKISË CËRRIK

AN EVENT WAS HELD AT THE VILLAGE GOSTIME, CËRRIK

21 Korrik 2020 / 21 July 2020

“Persekutimi i ‘kulakëve’ në diktaturë, Shaban Plaka”, dokumentar i gazetares Luljeta Progni u prezantua në fshatin Gostimë, të Bashkisë Cërrik, në kuadër të 45-vjetorit të vdekjes së Shaban Plakës. Dokumentari u realizua me materialet arkivore mbi familjen Plaka, vëllezërit Shaban dhe Ibrahim Plaka, të tërhequra nga familjarët pranë Autoritetit, si dhe dëshmitë e familjarëve. Në aktivitet, ishin të pranishëm përfaqësues nga Autoriteti, komuniteti i të përndjekurve të zonës, shoqatave të të drejtave të njeriut, familjarë dhe bashkëfshatarë.

"The persecution of the "kulaks" in the dictatorship, Shaban Plaka", a documentary by journalist Luljeta Progni was presented in the village of Gostime in the Cërrik Municipality, in the framework of the 45th anniversary of the death of Shaban Plaka. The documentary was based on archival materials from Plaka's family, brothers Shaban and Ibrahim, withdrawn from the relatives at the Authority, as well as testimonies of the family members. Representatives from the Authority, the persecuted community of the area, human rights associations, family members and fellow villagers were present at the activity.



PELEGRINAZH NË KAMPIN E TEPELENËS

PILGRIMAGE AT THE TEPELENA CAMP

23 Gusht 2020 / 23 August 2020

Në Ditën Europiane të Përkujtimit të Viktimave të Sistemeve Totalitare, Autoriteti në kampin e Tepelenës, si çdo vit, në pelegrinazhin e dhimbjes, me ata që i mbijetuan dhe trashëgimtarët e tyre.

At the European Day of Commemoration of the Victims of Totalitarian Systems. The Authority at the Tepelena's camp, as every year in the pilgrimage of pain, with those who survived and their heirs.



Ekipi i Autoritetit dhe anëtari i Autoritetit, z. Simon Mirakaj.

The team of the Authority and the member Mr. Simon Mirakaj.

U ZHVILLUA TRYEZA E RRUMBULLAKËT “95 VJET MARTIN CAMAJ, VEPRA DHE PËRNDJËKJA”

WAS HELD THE ROUND TABLE “95 YEARS OF MARTIN CAMAJ, HIS WORK AND PERSECUTION”

28 Gusht2020 / 28 August 2020

U mbajt tryeza e rrumbullakët “95 vjet Martin Camaj, vepra dhe përndjekja”, në mjediset e Pallatit të Brigadave, në Tiranë, në një trajtim shumëplanësh të jetës dhe veprimtarisë së tij. Të pranishëm ishin: Kryeministri i vendit, z. Edi Rama, Kryetarja e AIDSSH-së, znj. Gentiana Sula, Dr. Erika Camaj, bashkëshorte e Prof. Martin Camajt dhe kryetare e nderit të shoqatës, Prof. Dr. Bardhyl Demiraj, drejtues i katedrës së Albanologjisë në Universitetin Ludwig Maximilian, Mynih, bashkorganizator i aktivitetit, z. Simon Mirakaj, anëtar i AIDSSH-së, historianë: Erald Kapri dhe Sonila Boçi, Nevila Nika, Ardita Repishti, znj. Dagmar Hovestadt e BSTU Gjermani, bashkorganizatorë të aktivitetit, Z. Bujar Hudhri, botues i Camajt në Shqipëri, Prof. Ledi Shamku, Znj. Rita Gjeka, drejtuese e Teatrit “Migjeni”, z. Lisandri dhe znj. Aristeja Kola.



The round Table “95 years Martin Camaj, work and persecution”, was held in the premises of the Brigade’s Palace in Tirana in a multiplan treatment of his work and activity. Were present Prime Minister of Albania, Mr. Edi Rama, Chairwoman of AIDSSH, Ms. Gentiana Sula, Dr. Erika Camaj, wife of Professor Martin Camaj and honorary chairwoman of the association, Prof. Dr. Bardhyl Demiraj, Head of the department of Albanianology at the University Ludwig Maximilian, Mynih, co-organiser of the activity Mr. Simon Mirakaj, Member of AIDSSH, historian Erald Kapri and Sonila Boçi, Nevila Nika, Ardita Repishti, Ms. Dagmar Hovestadt and BSTU Germany, co-organisers of this activity, Mr. Bujar Hudhri, publisher of Camaj in Albania, Prof. Ledi Shamku, Ms. Rita Gjeka, Head of Theatre “Migjeni”, Mr. Lisandri and Ms. Aristeja Kola.



Z. Edi Rama, Kryeministri i Shqipërisë, gjatë fjalës së tij dhe Kryetarja e Autoritetit, znj. Gentiana Sula.

Mr. Edi Rama, Prime Minister of Albania during his speech at the event and the Chairwoman of the Authority Ms. Gentiana Sula.




Z. Erald Kapri, historian, me kumtesën: “Jeta e Martin Camajt në kontekstin e Luftës së Ftohtë”.

Mr. Erald Kapri, historian during his speech: “The life of Martin Camaj in the context of the Cold War.”



Znj. Ardita Repishti, Drejtore e Mbështetjes Shkencore dhe Edukimit qytetar.

Ms. Ardita Repishti, Director of Scientific Support and Civic Education.



Znj. Sonila Boçi, gjatë kumtesës për Martin Camajn.

Ms. Sonila Boçi during the speech for Martin Camaj.



Z. Bujar Hudhri, botues i veprës së Martin Camajt.

Mr. Bujar Hudhri, publisher of the work of Martin Camajt.




Znj/Mrs Nevila Nika, historiane/historian.



Znj. Ledi Shamku-Shkreli mbajti kumtesën me titull: "Profecia sociolinguistike e Camajt".

Ms. Ledi Shamku-Shkreli held her speech with title: "Sociolinguistic Prophecy of Camajt".



Historiani Bardhyl Demiraj, shefi aktual i Departamentit të Albanologjisë në Universitetin "Ludwig Maximilians" në Mynih, Gjermani - pozicion që dikur e ka mbajtur Martin Camaj, - në fjalën e tij online "Dosjet 'Camaj' në Mynih".

Historian Bardhyl Demiraj, Actual Head of Department of Albanianology at the University "Ludwig Maximilians" in Mynih of Germany, this position was held before by Martin Camaj in his speech online "Files "Camaj" in Mynih.



Znj/Ms Iris Elezi, Drejtore e Arkivit Qendror Shtetëror të Filmit / *Head of the Central State Archive of Film.*



Znj/Ms Rita Gjeka, drejtoresha e Teatrit "Migjeni" Shkodër / *Head of Theatre "Migjeni" Shkodër.*




Znj/Ms Majlinda Bushaj, nga Universiteti "Luigj Gurakuqi" në Shkodër, me kumtesën: "Sintaksa e Martin Camajt - pasuri e papërsëritshme e gjuhës shqipe" / *from the University of Shkodra "Luigj Gurakuqi" Shkodër with the speech from "Syntax of Martin Camaj - unrealized wealth of Albanian language".*

Në lidhje të drejtpërdrejtë nga SHBA-ja, me kumtesën: "Mendimi kritik i Arshi Pipës mbi veprën 'Dranja', të Martin Camajt".

Lisandri Kola LSA/Department of Slavic Languages and Literatures.
University of Michigan, Ann Arbor dhe znj. Aristeia Kola LSA/International Institute/International and Regional Studies.
University of Michigan, Ann Arbor.

Live from United States of America with their speech: "Critical thought of Arshi Pipa on the work Dranja of Martin Camaj".

*Lisandri Kola LSA/Department of Slavic Languages and Literatures.
University of Michigan, Ann Arbor and Ms. Aristeia Kola LSA/International Institute/International and Regional Studies.
University of Michigan, Ann Arbor.*






WEBINARI RAJONAL "TOWARD POSITIVE PEACE: COUNTERING HATE SPEECH"

THE REGIONAL WEBINAR "TOWARD POSITIVE PEACE: COUNTERING HATE SPEECH"

22 Shtator 2020 / 22 September 2020

Kryetarja e AIDSSH-së, në Ditën Ndërkombëtare të Paqes, gjatë takimit rajonal, mbi gjuhën e urrejtjes dhe përpjekjet aktive për paqe në webinarin "Toward positive peace: countering hate speech", në partneritet me Youth for Peace, Somborski Edukativni Centar- SEC.

The Chairwoman of AIDSSH, at the International Day of Peace, in the regional meeting on hate speech and active efforts for peace at the webinar "Toward Positive Peace: Countering Hate Speech", in partnership with Youth for Peace, Somborski Edukativni Centar- SEC.



TAKIM ME PËRFAQËSUES TË “FRIDRICH EBERT SHTIFTUNG” (FES) SHQIPËRI, NË KUADËR TË PROJEKTIT TË PËRBASHKËT: “MENDIMI POLITIK I SË MAJTËS”

MEETING WITH THE PARTICIPANTS OF FRIDRICH EBERT SHTIFTUNG (FES) ALBANIA, IN THE FRAME OF JOINT PROJECT “POLITICAL THOUGHT OF THE LEFT”

17 Shtator 2020 / 17 September 2020



**TAKIME, SHKËMBIME, IDE DHE BASHKËPUNIME TË ARDHSHE ME SHTËPINË BOTUESE “BERK”,
NË KUADËR TË PËRGATITJEVE PËR “DIALOGUN E TIRANËS”**

**MEETINGS, EXCHANGES, IDEAS AND FUTURE COLLABORATIONS WITH BERK PUBLISHING HOUSE,
AS PART OF THE PREPARATIONS FOR “THE DIALOGUE OF TIRANA”**


3 Shtator 2020 / 3 September 2020



Znj/Ms Ledi Shamku-Shkreli, botuese
e “BERK” / *Publisher of “BERK”.*

Znj/Ms Ardita Repishti,
Znj/Ms Gentiana Sula,
Z/Mr Simon Mirakaj.





TAKIM NË INSTITUTIN E ARKEOLOGJISË

MEETING AT THE INSTITUTE OF ARCHEOLOGY

5 Tetor 2020 / 5 October 2020



U diskutua me drejtorin, z. Luan Përzhita, anëtar i grupit të punës, mbi hapat e ardhshëm dhe protokollet përkatëse për kërkimin, identifikimin, gërmimin dhe zhvarrimin e të zhdukurve në diktaturë, me asistencën e ekspertëve të fushës dhe përdorimin e pajisjeve të duhura.

Discussion with the head of the institute Ms. Luan Përzhita, member of the work group, on the future steps and the relevant protocols for the research, identification, excavation and exhumation of missing people in dictatorship with the assistance of the experts of the field and using the right equipment.

TAKIME DHE BASHKËPUNIM ME PUSHTETIN LOKAL

MEETINGS AND COLLABORATION WITH THE LOCAL GOVERNMENT

8 Tetor 2020 / 8 October 2020

Në kuadër të organizimit të dialogut me pushtetin vendor për nderimin e personaliteteve të rezistencës, solidaritetit njerëzor dhe përkujtimit të të dënuarve ende të zhdukur, u zhvilluan takime me pushtetin lokal dhe aktorë të fushës së kujtesës, në Korçë dhe Maliq.

In the frame of the dialogue with the local government for honoring personalities of resistance, human solidarity and commemoration of the convicted still missing were held meetings with actors in the field of remembrance, and municipalities of Korça and Maliq.



Z. Festim Tomorri, Drejtor i Trashëgimisë Kulturore, diskutim rreth vendit ku do të vendoset memoriali për të përkujtuar “Kampin e Punës së Detyruar”, Maliq.

Mr. Festim Tomorri, Director of Cultural Heritage discussion where it will be placed the Memorial to commemorate “Forced Labor Camp” Maliq.

Z. Gëzim Topciu Kryetar i Bashkisë Maliq dhe përfaqësuesit e Autoritetit.

Mr. Gëzim Topciu, Mayor of Maliq and representatives of the Authority.



TAKIM NË INSTITUTIN E MJEKËSISË LIGJORE

MEETING AT THE INSTITUTE OF LEGAL MEDICINE

7 Tetor 2020 / 7 October 2020

U diskutua me z. Bledar Xhemali, Drejtor i Institutit të Mjekësisë Ligjore, mbi hapat e ardhshëm dhe protokollet përkatëse për kërkimin, identifikimin, gërmimin dhe zhvarrimin e të zhdukurve në diktaturë, me asistencën e ekspertëve të fushës dhe përdorimin e pajisjeve të duhura.

Discussing with the Mr. Bledar Xhemali, Director of Institute of Legal Medicine on the future steps and relevant protocols for the research, identification, excavation and exhumation of missing persons in dictatorship, with the assistance of the experts of the field and using the right equipment.



TAKIM INFORMUES ME PROKURORIN E PËRGJITHSHËM

MEETING WITH THE GENERAL PROSECUTOR

21 Tetor 2020 / 21 October 2020

Ekipi i AIDSSH, i përfaqësuar nga Kryetarja, znj. Gentiana Sula, anëtari z. Simon Mirakaj dhe sekretari i përgjithshëm, z. Skënder Vrioni, zhvilloi një takim informues me Prokurorin e Përgjithshëm, z. Olsian Çela dhe përfaqësuesin e departamentit të koordinimit me institucionet e tjera, z. Sokol Stojani.

The team of AIDSSH, represented from the Chairwoman, Ms. Gentiana Sula, member Mr. Simon Mirakaj and General Secretary of the Authority Mr. Skënder Vrioni, held an informative meeting with the general prosecutor Mr. Olsian Çela and the representative of the general prosecutor's office, head of coordination department with other institutions, Mr. Sokol Stojani.



AIDSSH I DORËZON KANTIERIN E PUNIMEVE KOMPANIVE FITUESE (JOINT-VENTURE E OB KONSTRUKSION SHPK DHE ED KONSTRUKSION SHPK)

AIDSSH HANDS OVER THE CONSTRUCTION SITE TO THE WINNING COMPANIES (JOINT-VENTURE OF OB KONSTRUKSION LTD AND ED KONSTRUKSION LTD)

26 Tetor 2020 / 26 October 2020

Sipas afatit të parashikuar të punimeve, kompanitë do të rikonstruktojnë ndërtesën e institucionit. Proceset e punës do të ndiqen në vijim, për të mundësuar kushte të përshtatshme për arkivin, stafin, individët dhe studiuesit e interesuar. Punimet mundësohen nga granti i përfituar nga Qeveria Suedeze, për krijimin e kushteve dhe standardeve bashkohore të punës, përfshirë edhe shërbimet e integruara TIK.

According to the prescribed deadline these companies will reconstruct the building of the institution. working process will be followed in the future to enable suitable conditions for the archive, the staff and interested researchers and individuals. the works will be financed from the grant received from the Swedish government, for the creation of contemporary work conditions and standards, including TIK integrated services.



TAKIM NË MINISTRINË E ARSIMIT SPORTIT DHE RINISË

MEETING WITH MINISTRY EDUCATION, SPORT AND YOUTH

11 Dhjetor 2020 / 11 December 2020

Në takimin mes Kryetares së Autoritetit, znj. Gentiana Sula dhe Ministres znj. Evis Kushi u diskutua posaçërisht, bashkëveprimi i AIDSSH me Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, në fushën e edukimit qytetar dhe kërkimit shkencor.

In the meeting between Chairwoman of the Authority, Ms. Gentiana Sula and the Minister of Education, Sport and Youth, Ms. Evis Kushi was discussed especially the interplay of AIDSSH with the Ministry in the field of civic education and scientific research.



MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI/COOPERATION AGREEMENT

U NËNSHKRUA MARRËVESHJA E BASHKËPUNIMIT MIDIS AUTORITETIT PËR INFORMIMIN MBI DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHETIT DHE QENDRËS “MEMO”

THE SIGNING OF THE AGREEMENT OF COLLABORATION BETWEEN THE AUTHORITY ON ACCESS TO INFORMATION ON THE FORMER STATE SECURITY SERVICE AND THE “MEMO” CENTRE

10 Janar 2020 / 10 January 2020



Objekt i marrëveshjes, të nënshkruar mes znj. Gentiana Sula, Kryetare e Autoritetit dhe znj. Ema Andrea, Drejtore Ekzekutive e Qendrës “Memo”, është institucionalizimi i marrëdhënieve të bashkëpunimit të ndërsjellë në fushën e kujtesës, gjatë rishqyrtimit historik të veprimtarisë së Ish-Sigurimit së Shtetit, për rivlerësimin e personaliteteve dhe ngjarjeve historike, si dhe kontributi në realizimin e projekteve të kujtesës.


The object of the agreement that was signed by Ms. Gentiana Sula, Chairwoman of the Authority and Ms. Ema Andrea, executive director of “Memo” Centre was the institutionalizing of mutual cooperative relationship collaboration in the field of memory during the historical review of the activity of Former State Security, for the re-evaluation of personalities and historical events, as well as the contribution to the realization of memory projects.

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI MIDIS AIDSSH DHE UNIVERSITETIT EUROPIAN TË TIRANËS

THE AGREEMENT OF COLLABORATION BETWEEN THE AIDSSH AND THE EUROPEAN UNIVERSITY OF TIRANA

16 Janar 2020 / 16 January 2020

Objekt i marrëveshjes së nënshkruar midis Kryetares së Autoritetit dhe znj. Nevila Nika, Rektore e UET-it, është institucionalizimi i marrëdhënieve të bashkëpunimit të ndërsjellë në fushën e kujtesës, gjatë rishqyrtimit historik të veprimtarisë së Ish-Sigurimit të Shtetit, nëpërmjet aktiviteteve të përbashkëta ndërgjegjësuese dhe trajnimeve, për të rritur ndërgjegjësimin në brezat e rinj, nëpërmjet edukimit qytetar dhe mbështetjes së kërkimit shkencor.



The Object of the agreement signed by the Chairwoman of the Authority and Ms. Nevila Nika, Rector of EUT, was the institutionalization of mutual cooperative relationship collaboration in the field of memory during the historical review of the activity of Former State Security, through common sensitization activities and training, to raise awareness among the younger generations, through civic education and scientific research.

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI MES AIDSSH DHE KOMISIONIT NDËRKOMBËTAR PËR PERSONAT E ZHDUKUR

THE COLLABORATION AGREEMENT BETWEEN AIDSSH AND INTERNATIONAL COMMISSION ON MISSING PERSONS

10 Gusht 2020 / 10 August 2020

U nënshkrua marrëveshja e bashkëpunimit mes AIDSSH dhe Komisioni Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur (ICMP), për projektin “Rritja e ndërgjegjësimit të publikut për drejtësinë tranzitore dhe të pajtimit: të zhdukurit në komunizëm”, 2020- 2021.

The signing of the collaboration agreement between AIDSSH and ICMP (International Commission on Missing Persons) for the project: “Raising the public awareness of transitional and reconciliation law; missing persons in communism, 2020-2021.”



MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI MIDIS AIDSSH DHE SHOQATËS “TIRANA”

COLLABORATION AGREEMENT BETWEEN THE AIDSSH AND “TIRANA” ASSOCIATION

22 Tetor 2020 / 22 October 2020

Objekt i marrëveshjes së nënshkruar midis Kryetares së Autoritetit dhe z. Arben Tafaj, Kryetar i shoqatës, është institucionalizimi i marrëdhënieve të bashkëpunimit të ndërsjellë në fushën e kujtesës, gjatë rishqyrtimit historik të veprimtarisë së Sigurimit të Shtetit, nëpërmjet aktiviteteve të përbashkëta ndërgjegjësuese, që hedhin dritë në historinë gjysmëshekullore të Tiranës kryeqytet, në diktaturë.

The object of the agreement signed by Chairwoman of the Authority and Mr. Arben Tafaj, Head of “Tirana” Association was the institutionalization of mutual cooperative relationship collaboration in the field of memory during the historical review of the activity of Former State Security through common sensitization activities, that shed light on half a century of history of Tirana, capital in dictatorship.

